



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivery	27.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKQMSHCK	3752/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.452/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Valentina Kaçandolli-Bektashi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.452/2022 të datës 13.05.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër 657-2022 të datës 11.05.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.452/2022 e datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 657-2022 i datës 11.05.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 21.01.2022 ka shpallur konkurs për pozitën e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ si dhe pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit por i njëjti nuk është përzgjedhur si kandidati i suksesshëm për pozitën përkatëse të punës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 10.03.2022 ka publikuar njoftimin për kandidatët e suksesshëm për dy pozitën e lartcekura.

Ankuesi kundër këtij njoftimi më datë 14.04.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendrorë Zgjedhor, me datë 11.05.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.657-2022 përmes të cilit ka hedhur si të pasafatshme ankesën me numër 555/2022 dhe me numër 556/2022 të datave 14.04.2022 të ushtruara nga ankuesi,

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 13.05.2022 nëpërmjet e-mail-it zyrtar të ankesave ankesa.kpmshek@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe ka marr numrin e protokollit 2782/2022, ndërsa numrin e lëndës A.nr.452/2022. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.05.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Komisionit Qendror Zgjedhor. Kjo e fundit ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me datë 01.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 13.05.2022; Konkursi i datës 21.01.2022; e-mail i datës 18.02.2022; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 10.03.2022 për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ si dhe për vendin punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive; E-mail i datës 13.04.2022; Vendimi A.nr. 224/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A.nr. 245/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 11.05.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor; Informata e përgjithshme e datës 01.04.2022; Ankesa e ankuesit e datës 14.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 21.01.2022 për miratimin e shpalljes së konkursit; Vendimi i datës 09.03.2022 për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim; Udhëzimi Administrativ i datës 19.01.2022; Vendimi i datës 12.08.2022 për ndryshim dhe plotësimin të udhëzimit administrativ; e-mail i datës 21.01.2022 për publikim të konkursit; Regjistri i aplikacioneve të pranuar (Form.KQZ-R-04); Vendimi i datës 14.02.2022 për formimin e Komisionit Përzgjedhës; e-mail i datës 14.02.2022, Lista e kandidatëve për verifikim; Përcaktimi i kritereve për përfshirje në listën e ngushtë (Form.KQZ-R-05); Raporti i datës 16.02.2022; Lista e ngushtë e kandidatëve për pozitën Drejtor Ekzekutiv; e-mail i datës 18.02.2022; Kriteret e vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistimit me gojë e datës 23.02.2022; e-mail i datës 23.02.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale (Form.KQZ-R-09) për vendin e punës Drejtor Ekzekutiv; Renditja përfundimtare e kandidatëve për vendin e punës Drejtor Ekzekutiv; e-mail i datës 10.03.2022; Njoftimi i datës 10.03.2022 për kandidatin e suksesshëm për vendin e punës Drejtor Ekzekutiv; e-mail i datës 10.03.2022; Raporti i datës 01.03.2022 i Komisionit Përzgjedhës për vendin e punës Drejtor Ekzekutiv; Pikët e kandidatëve nga anëtarët e komisionit të cilët kanë aplikuar për pozitën Drejtor Ekzekutiv; Kërkesa për punsim e kandidatit për vendin e punës Drejtor Ekzekutiv me të gjithë dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e kandidatit për vendin e punës Drejtor Ekzekutiv me të gjithë dokumentacionin e bashkangjitur; Vendimi i datës 21.01.2022 për miratimin e shpalljes së konkursit për vendin e punës Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së; Regjistri i aplikacioneve të pranuar (Form.KQZ-R-04) për

vendin e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv; Vendimi i datës 14.02.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; e-mail i datës 08.02.2022; e-mail i datës 22.02.2022, 14.02.2022; Lista e kandidatëve për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Pikët e kandidatëve nga anëtarët e komisionit të cilët kanë aplikuar për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; Raporti i datës 16.02.2022 nga Kryesuesi i Komisionit përzgjedhës për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; e-mail i datës 14.02.2022 dhe 21.02.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; Renditja përfundimtare e kandidatëve për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ (Form.KQZ-R-10); Raporti i datës 01.03.2022 për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; Vendimi i datës 09.03.2022 për emërimin e kandidatit për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; Njoftimi i datës 10.03.2022 për përzgjedhjen e kandidatit për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ; Kërkesa për punësim e kandidatit _____ për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e kandidatit _____ për vendin e punës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ me dokumentacionin e bashkangjitur si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga provat e administruara të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), me datë 21.01.2022 ka shpallur konkurs për pozitën e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ, si dhe pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit por i njëjti nuk është përzgjedhur si kandidati i suksesshëm për pozitën përkatëse të punës. SKQZ, me datë 10.03.2022 ka bërë njoftimin për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv, si dhe pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive.

Kundër Njoftimit të datës 10.03.2022 lidhur me përzgjedhjen përfundimtare, ankuesi me datë 14.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër 555/2022 dhe 556/2022 tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së, me pretendimin ankimor se kandidati i përzgjedhur në pozitën e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv, si dhe kandidati i përzgjedhur në pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit të datës 21.01.2022 për sa i përket kualifikimit, aftësive dhe përvojës së punës, dhe se kandidatët me rastin e plotësimit të aplikacionit për punësim nuk kanë ofruar të dhëna të sakta lidhur me përvojën e punës menaxheriale.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 11.05.2022 me Vendimin me numër 657-2022 ka hedhur poshtë si të jashtë afatshme ankesën me numër 555/2022 dhe numer 556/2022 te parashtruar nga ankuesi me datë 14.04.2022, kundër Njoftimit të datës 10.03.2022 lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv, si dhe për pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive.

Ankuesi, i pa kënaqur me Vendimin me numër 657-2022 të datës 11.05.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 13.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2782/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit me numër 657-2022 të datës 11.05.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave analizoje shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha së bashku, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit në lidhje me ligjshmërinë e këtij vendimi është i pa bazuar sepse nga administrimi i provave të lëndës rezultoi se Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor, me datë 10.03.2022 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm për pozitën e punës Zëvendës Kryeshf Ekzekutiv, si dhe pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive, dhe se në njoftimin e publikuar është cekur se: *"...ai/ajo mundë të ankohen me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së, i cili e shqyrton dhe vendos për ankesën, brenda 30 ditëve nga data në të cilën vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet për kandidatët nga institucioni përkatës"*, ndërsa ankuesi _____ kundër njoftimit të datës 10.03.2022 lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve, me datë 14.04.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Andaj, meqenëse Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me datë 10.03.2022 ka përcjell në e-mailin zyrtar të ankuesit njoftimin lidhur me kandidatin e suksesshëm dhe të njëjtin e ka publikuar edhe në web faqen zyrtare të KQZ-së www.kqz-ks.org, si dhe duke marr parasysh se ankuesi është udhëzuar nga organi i punësimit në mënyrë të rregullt për ushtrimin e mjeteve juridike në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Kolegji konstaton se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 14.04.2022 është jashtë afatit të përcaktuar prej 30 ditësh, siç përcaktohet me nenin 39 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurën e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuere të Nëpunësve në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Bazuar në këto rrethana Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me rastin e vendosjes për hedhje poshtë të ankesës si të papranueshme (jashtë afatshme), ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe rrjedhimisht ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.452/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Procesmbajtëse

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit Qendror Zgjedhor;
- Udhëheqësit të Personelit në Komision Qendror Zgjedhor; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së